



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 189

Tiranë – E hënë, 31 gusht 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 635, datë 27.8.2026	Për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Koordinimit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit..... 18737
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 636, datë 27.8.2026	Për disa ndryshime në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar..... 18738
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 637, datë 27.8.2026	Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar..... 18738
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 639, datë 27.8.2026	Për transferimin e pronësisë së 89,652% të aksioneve të shoqërisë “Duhan Cigare” sh.a., në likuidim, Shkodër, nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit tek Bashkia Shkodër..... 18751
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 640, datë 27.8.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 667, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit”..... 18751
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 642, datë 27.8.2026	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i linjës 110 kV Fier–Kafaraj dhe vendosja e traktit të ri në nënstacionin Fier”..... 18752
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 643, datë 27.8.2026	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi urban në zonën e tregut të hapur të qytetit të Vlorës”.. 18756
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 644, datë 27.8.2026	Për kalimin te Bashkia Krujë të njërive të banimit në ndërtesa (pallat) 18757

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 648, datë 27.8.2026	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Arsimit të pasurisë nr. 1/136-nd, në zonën kadastrale 8320, për Qendrën e Shërbimeve Arsimore, dhe revokimin e së drejtës së pronësisë të Bashkisë Tiranë.....	18764
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 849, datë 24.8.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	18769
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 850, datë 24.8.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.....	18771
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 851, datë 24.8.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Austrisë.....	18772
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 852, datë 24.8.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive, të shfaqur në shtetin e Rumanisë.....	18774
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 853, datë 24.8.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Moldavisë.....	18775



VENDIM

Nr. 635, datë 27.8.2026

**PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN
E QENDRËS KOMBËTARE TË
KOORDINIMIT PËR MENAXHIMIN E
INTEGRUAR TË KUFIRIT¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 28, të ligjit nr. 39/2025, “Për kontrollin e kufirit shtetëror”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Qendrës Kombëtare të Koordinimit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (në vijim Qendra) për shkëmbimin në kohë reale të informacionit dhe lehtësimin e bashkëpunimit midis autoriteteve kombëtare, me përgjegjësi në menaxhimin e integruar të kufirit, kontrollin dhe mbikëqyrjen e tij me qendrat kombëtare të koordinimit të vendeve të rajonit e ato partnere, si dhe me Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare (FRONTEX).

2. Qendra Kombëtare e Koordinimit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit është strukturë koordinuese ndërinstitucionale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe përbëhet nga përfaqësues të agjencive të zbatimit të ligjit, që operojnë në kufi, si më poshtë vijon:

- a) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin;
- b) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- c) Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

3. Qendra do të drejtohet nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin.

4. Qendra bashkëpunon, për ushtrimin e funksioneve të saj, me Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare, Rojën Bregdetare dhe institucione të tjera shtetërore, të angazhuara në menaxhimin e integruar të kufirit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shkëmbimi i informacionit dhe prezenca e përfaqësuesve të këtyre

institucioneve në Qendër realizohet me kërkesë të Qendrës dhe në përputhje me kompetencat ligjore të secilit institucion.

5. Titullarët e autoriteteve, të përcaktuara në pikat 2 dhe 4, të këtij vendimi, brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, caktojnë nga një përfaqësues dhe njoftojnë me shkrim Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Pas fillimit të funksionimit të Qendrës, në rast ndryshimi të përfaqësuesit të caktuar, titullari i autoritetit përkatës njofton menjëherë Qendrën.

6. Përfaqësuesit e autoriteteve kombëtare në Qendër kanë akses në bazat shtetërore të të dhënave të institucioneve që përfaqësojnë për kryerjen e detyrave funksionale dhe përgjegjësi, të parashikuara në pikën 2, të nenit 28, të ligjit nr. 39/2025, “Për kontrollin e kufirit shtetëror”. Çdo veprimtari ndërhyrëse në të dhënat e sipërpërmendura është e gjurmueshme.

7. Qendra ka akses në të gjitha pamjet e kamerave të instaluar dhe që janë në përdorim nga agjencitë ligjzbatuese që operojnë në kufi, si dhe në sistemin e mbikëqyrjes së kufirit tokësor, detar, përveç sistemeve me qëllim të mirëfilltë ushtarak, liqenor dhe lumor.

8. Informacioni i mbledhur dhe i përpunuar nga Qendra, në përmbushje të detyrave funksionale, administrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, legjislacionin përkatës të bazave të të dhënave shtetërore, si dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

9. Me qëllim hartimin dhe administrimin e raporteve të situatës kombëtare të sigurisë kufitare, si dhe hartimin e shpërndarjen e raportit ditor të aktivitetit ditor, agjencitë e zbatimit të ligjit, që operojnë në kufi, si dhe Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare informojnë Qendrën në kohë reale për çdo situatë apo incident përgjatë kufirit shtetëror tokësor, detar, liqenor e lumor, si dhe në pikat e kalimit të kufirit ajror, tokësor, detar, liqenor dhe do të dërgojnë pranë Qendrës raportin ditor të aktivitetit të shërbimeve përkatëse, të angazhuara në menaxhimin e kufirit.

10. Qendra do të ketë faqen e saj zyrtare, ku do të pasqyrohen informacione dhe kuadri ligjor,

¹ Ky vendim është përafëruar pjesërisht me rregulloren (BE) 2019/1896 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 nëntor 2019, mbi Rojën Kufitare dhe Bregdetare Evropiane dhe shfuqizimin e rregulloreve (BE) nr.

1052/2013 dhe (BE) 2016/1624, nr. CELEX: 32019R1896, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian nr. L 295/1, datë 14.11.2019, faqe 1–131.



nënligjor, në gjuhën shqipe dhe angleze, që lidhen me qarkullimin ndërkufitar të shtetasve e të mallrave.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, Roja Bregdetare dhe institucionet e tjera shtetërore, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për menaxhimin e integruar të kufirit, sipas kompetencave ligjore përkatëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet financiare nga data 1 janar 2027.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçi

VENDIM
Nr. 636, datë 27.8.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, e 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit “Lista e OKB-së”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Në listën e shkronjës “A”, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”, ndryshohen të dhënat për 5 (pesë) individë, të renditur në listën e konsoliduar të

Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për individët e shpallur anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçi

NDRYSHIME NË LISTËN E INDIVIDËVE TË SHPALLUR ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME TALIBANËT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT

(LISTA E OKB-së)

A. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME TALIBANËT

a) Ndryshime në “Listën e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”.

1: *HAMDULLAH: NOMANI*

2: *ABDUL-HAQ: WASSIQ*

3: *NOOR MOHAMMAD: SAQIB*

4: *SIRAJUDDIN: JALLALOUDINE: HAQQANI*

5: *GUL: AGHA: ISHAKZAI*

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahen në Agjencinë e Intelgjencës Financiare.

VENDIM
Nr. 637, datë 27.8.2026

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në pikën 1, të kreut I, pas fjalëve "... (CFSP) 2025/2072 ..." shtohen "... (CFSP) 2026/1542 ...";

b) Në aneksin 1, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2026/1542, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu



Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian

EN
Seria L

2026/1542

3.7.2026

VENDIMI I KËSHILLIT (CFSP) 2026/1542

i datës 3 Korrik 2026

ndryshimi i Vendimit (CFSP) 2018/1544 në lidhje me masat kufizuese kundër përhapjes dhe përdorimit të armëve kimike

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Duke qenë se:

(1) Më 15 Tetor 2018, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2018/1544 (1).

(2) Më 16 Shkurt 2024, autoritetet Ruse njoftuan vdekjen e Alexei Navalny-t, ndërsa ai ishte i ndaluar në një koloni penale (internim) në Rusi. Navalny i ishte nënshtruar ndjekjes penale dhe burgosjes për motive politike dhe më parë kishte qenë viktimë e një sulmi helmues që përfshinte një agjent nervor toksik të grupit Novichok, në Gusht 2020.

(3) Në këtë kontekst, dhe duke pasur parasysh rrethanat e vdekjes së Aleksei Navalnyt, praninë e konfirmuar të epibatidinës në mostrat e marra prej tij pas vdekjes, si dhe përfundimin se helmimi me epibatidinë ka shumë të ngjarë të ketë qenë shkaku i vdekjes së tij, gjashtë persona duhet të përfshihen në listën e personave fizikë dhe juridikë, subjekteve dhe organeve që u nënshtrohen masave kufizuese, të përcaktuar në Shtojcën e Vendimit (CFSP) 2018/1544.

(4) Prandaj, Vendimi (CFSP) 2018/1544 duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,



KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Shtojca e Vendimit (CFSP) 2018/1544 ndryshohet në përputhje me Shtojcën e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Bërë në Bruksel, më 3 Korrik 2026.

Për Këshillin

President

T.BYRNE

(1) Vendimi i Këshillit (CFSP) 2018/1544 i 15 Tetorit 2018 në lidhje me masat kufizuese kundër përhapjes dhe përdorimit të armëve kimike (OJ L 259, 16.10.2018, f. 25, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2018/1544/oj>).



SHTOJCË

Në Shtojcën e Vendimit (CFSP) 2018/1544, nën titullin "A. Personat fizikë", shtohen shënimet e mëposhtme:

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet për përcaktimin	Data e listimit
26.	Igor Yuryevich БАВКИН (Игорь Юрьевич БАБКИН)	Gjinia: Mashkull Data e lindjes: 19.4.1978 Vendi i lindjes: Rajoni i Çerkasit, BRSS (tani Ukrainë) Shtetësia: Ruse INN- (Numri i identifikimit të tatimpaguesit) : 770170119783 Funksioni: Drejtues i laboratorit në Qendrën Shkencore "Signal" (e njohur gjithashtu si SC Signal, INN 7718813855)	Igor Babkin është shkencëtar në fushën ushtarake dhe drejtues i laboratorit në Qendrën Shkencore "Signal" (e njohur gjithashtu si SC Signal). Babkin ka punuar më parë me strukturat e mbrojtjes kimike, radiologjike dhe biologjike pranë Ministrit të Mbrojtjes të Federatës Ruse, përfshirë Qendrën e 27-të Shkencore dhe Akademinë Ushtarake për Mbrojtjen Radiologjike, Kimike dhe Biologjike. Babkin drejtoi një grup studiuësish në Qendrën Shkencore "Signal", i cili hulumtoi dhe publikoi artikuj mbi sintezën e epibatidinës, e cila u gjet te Aleksei Navalny pas vdekjes së tij. Për rrjedhojë, ai është i përfshirë në zhvillimin e epibatidinës si armë kimike. Prandaj, Igor Babkin është i përfshirë në zhvillimin e armëve kimike. Për më tepër, ai është i lidhur me Artur Aleksandrovich Zhironov, i cili është Drejtor i SC Signal.	3.7.2026
27.	Sergey Yevgenyevich GALAN (Сергей Евгеньевич ГАЛАН)	Gjinia: Mashkull Data e lindjes: 13.6.1970 Vendi i lindjes: Kramatorsk, BRSS (tani Ukrainë) Shtetësia: Ruse Funksioni: Shkencëtar i lartë në Qendrën Shkencore "Signal" (e njohur gjithashtu si SC Signal, INN - (Numri i identifikimit të tatimpaguesit) : 7718813855)	Sergey Galan është një shkencëtar i lartë në fushën ushtarake që punon në Qendrën Shkencore të Signal (e njohur edhe si SC Signal). Galan më parë ka punuar me strukturat e mbrojtjes kimike, radiologjike dhe biologjike brenda	3.7.2026

Unë, **Martin Xhaferaj**, përkthyes zyrtar i gjuhës Angleze, certifikuar nga Ministria e Drejtësisë me nr. Certificate **1059**, datë **31.07.2024**, deklaroj se kam përkthyer tekstin që më është paraqitur nga gjuha e burimit **anglisht** në gjuhën e synuar **shqip** me saktësi, me kujdesin e duhur dhe me përgjegjësi ligjore. **Datë** : 08.07.2026, **Cel** : 0675136322, **E-mail** : martin_alb01@hotmail.com –NIPT : M618220351



			Ministritë së Mbrojtjes Ruse, duke përfshirë Qendrën e 27-të Shkencore, Institutin Shtetëror të Kërkimeve Shkencore për Mjekësinë Eksperimentale dhe Institutin e Kërkimeve për Akustikën e Aplikuar. Së bashku me kolegët në Qendrën Shkencore të Signal, ai ka hulumtuar dhe botuar artikuj mbi sintezën e epibatidinës, e cila u gjet te Alexei Navalny pas vdekjes së tij. Prandaj, ai është i përfshirë në zhvillimin e epibatidinës si armë kimike. Prandaj, Sergey Galan është i përfshirë në zhvillimin e armëve kimike. Për më tepër, ai është i lidhur me Artur Aleksandrovich Zhirov, i cili është Drejtori i SC Signal.	
28.	Irina Dmitriyevna DEREVYAGINA (Ирина Дмитриевна ДЕРЕВЯГИНА)	Gjinia: Femër Data e lindjes: 24.3.1961 Shtetësia: Ruse INN - (Numri i identifikimit të tatimpaguesit) : 772815862404 Funksioni: Analiste e kërkimeve kimike në Institutin Shtetëror Shkencor-Kërkimor për Kiminë Organike dhe Teknologjinë (GosNIIOKhT)	Irina Derevyagina është analiste e kërkimeve kimike në Institutin Shtetëror Shkencor-Kërkimor për Kiminë Organike dhe Teknologjinë të Rusisë (GosNIIOKhT). Ajo ka qenë autore e dy punimeve kërkimore mbi aplikimet klinike dhe testimin e epibatidinës, e cila u gjet te Aleksei Navalny pas vdekjes së tij. Për rrjedhojë, ajo është e përfshirë në zhvillimin e epibatidinës si armë kimike. Prandaj, Irina Derevyagina është e përfshirë në zhvillimin e armëve kimike.	3.7.2026
29.	Mikhail Vasilyevich GUTSALYUK (Михаил Васильевич ГУЦАЛЮК)	Gjinia: Mashkull Data e lindjes: 2.3.1968 Shtetësia: Ruse INN INN - (Numri i identifikimit të tatimpaguesit) : 460501189420 Funksioni: Kolonel dhe drejtues i departamentit për organizimin e punës	Mikhail Gutsalyuk është kolonel dhe drejtues i departamentit për organizimin e punës shkencore dhe për përgatitjen e personelit shkencor dhe pedagogjik në Akademinë Ushtarake për Mbrojtjen	3.7.2026

Unë, **Martin Xhaferaj**, përkthyes zyrtar i gjuhës Angleze, certifikuar nga Ministria e Drejtësisë me nr. Certificate **1059**, datë **31.07.2024**, deklaroj se kam përkthyer tekstin që më është paraqitur nga gjuha e burimit **anglisht** në gjuhën e synuar **shqip** me saktësi, me kujdesin e duhur dhe me përgjegjësi ligjore. **Datë** : 08.07.2026, **Cel** :0675136322 , **E-mail** : martin_alb01@hotmail.com –NIPT : M618220351



		shkencore dhe për përgatitjen e personelit shkencor dhe pedagogjik në Akademinë Ushtarake për Mbrojtjen Radiologjike, Kimike dhe Biologjike	Radiologjike, Kimike dhe Biologjike. Së bashku me kimistë nga Qendra Shkencore “Signal” (e njohur gjithashtu si SC Signal), ai ka kryer kërkime mbi sintezën e epibatidinës, e cila u gjet te Aleksei Navalny pas vdekjes së tij. Për rrjedhojë, ai është i përfshirë në zhvillimin e epibatidinës si armë kimike. Prandaj, Mikhail Gutsalyuk është i përfshirë në zhvillimin e armëve kimike. Për më tepër, ai është i lidhur me Artur Aleksandrovich Zhirov, i cili është Drejtor i SC Signal.	
30.	Olga Petrovna YUDINA (Ольга Петровна ЮДИНА)	Gjinia: Femër Data e lindjes: 24.11.1986 Shtetësia: Ruse INN - (Numri i identifikimit të tatimpaguesit) : 462601484461 Funksioni: Kërkuese shkencore e lartë në Qendrën Shkencore “Signal” (e njohur gjithashtu si SC Signal, INN 7718813855)	Olga Yudina është kërkuese shkencore e lartë në Qendrën Shkencore “Signal” (e njohur gjithashtu si SC Signal). Ajo gjithashtu merr pagë nga Instituti Kërkimor për Akustikën e Zbatuar, i cili ka qenë i përfshirë në prokurimin e materialeve që mund të përdoren në prodhimin e agjentëve të armëve kimike. Së bashku me kolegë në Qendrën Shkencore “Signal”, ajo ka hulumtuar dhe publikuar artikuj mbi sintezën e epibatidinës, e cila u gjet te Aleksei Navalny pas vdekjes së tij. Për rrjedhojë, ajo është e përfshirë në zhvillimin e epibatidinës si armë kimike. Prandaj, Olga Yudina është e përfshirë në zhvillimin e armëve kimike. Për më tepër, ajo është e lidhur me Artur Aleksandrovich Zhirov, i cili është Drejtor i SC Signal.	3.7.2026
31.	Aleksey Vadimovich AKSYONOV (Алексей Вадимович АКСЕНОВ)	Gjinia: Mashkull Data e lindjes: 8.10.1978 Shtetësia: Ruse INN - (Numri i identifikimit	Aleksey Aksyonov është kërkues shkencor në Qendrën Shkencore “Signal” (e njohur	3.7.2026’.

Unë, **Martin Xhaferaj**, përkthyes zyrtar i gjuhës Angleze, certifikuar nga Ministria e Drejtësisë me nr. Certificate 1059, datë 31.07.2024 , deklaroj se kam përkthyer tekstin që më është paraqitur nga gjuha e burimit **anglisht** në gjuhën e synuar **shqip** me saktësi, me kujdesin e duhur dhe me përgjegjësi ligjore. Datë : 08.07.2026, Cel :0675136322 , E-mail : martin_alb01@hotmail.com –NIPT : M61822035I



		të tatimpaguesit): 366217317327 Funksioni: Kërkues shkencor në Qendrën Shkencore “Signal” (e njohur gjithashtu si SC Signal, INN 7718813855)	gjithashtu si SC Signal). Së bashku me kolegë në Qendrën Shkencore “Signal”, ai ka hulumtuar dhe publikuar artikuj mbi sintezën e epibatidinës, e cila u gjet te Aleksei Navalny pas vdekjes së tij. Për rrjedhojë, ai është i përfshirë në zhvillimin e epibatidinës si armë kimike. Prandaj, Aleksey Aksyonov është i përfshirë në zhvillimin e armëve kimike. Për më tepër, ai është i lidhur me Artur Aleksandrovich Zhiron, i cili është Drejtor i SC Signal.	
--	--	---	---	--

ELI -European Legislation Identifier - (Identifikuesi Evropian i Legjislacionit): <http://data.europa.eu/eli/dec/2026/1542/oj>
ISSN 1977-0677 (botim elektronik)



2026/1542

3.7.2026

COUNCIL DECISION (CFSP) 2026/1542**of 3 July 2026****amending Decision (CFSP) 2018/1544 concerning restrictive measures against the proliferation and use of chemical weapons**

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 15 October 2018, the Council adopted Decision (CFSP) 2018/1544 ⁽¹⁾.
- (2) On 16 February 2024, the Russian authorities announced the death of Alexei Navalny while he was detained in a penal colony in Russia. Navalny had been subjected to politically motivated prosecution and imprisonment and had previously been the victim of a poisoning attack involving a toxic nerve agent from the Novichok group in August 2020.
- (3) In that context, and in view of the circumstances of Alexei Navalny's death, the confirmed presence of epibatidine in samples taken from him after his death and the conclusion that poisoning with epibatidine was highly likely to have been the cause of his death, six persons should be included in the list of natural and legal persons, entities and bodies subject to restrictive measures set out in the Annex to Decision (CFSP) 2018/1544.
- (4) Decision (CFSP) 2018/1544 should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

The Annex to Decision (CFSP) 2018/1544 is amended in accordance with the Annex to this Decision.

*Article 2*This Decision shall enter into force on the date of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 3 July 2026.

For the Council



The President

T. BYRNE

⁽¹⁾ Council Decision (CFSP) 2018/1544 of 15 October 2018 concerning restrictive measures against the proliferation and use of chemical weapons (OJ L 259, 16.10.2018, p. 25, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2018/1544/oj>).

ANNEX

In the Annex to Decision (CFSP) 2018/1544, under the heading ‘A. Natural persons’, the following entries are added:

	Name	Identifying information	Grounds for designation	Date of listing
‘26.	Igor Yuryevich BABKIN (Игорь Юрьевич БАБКИН)	Gender: male DOB: 19.4.1978 POB: Cherkasy region, USSR (now Ukraine) Nationality: Russian INN: 770170119783 Function: head of laboratory at the Signal Scientific Centre (also known as SC Signal, INN 7718813855)	Igor Babkin is a scientist within the military sphere and head of laboratory at the Signal Scientific Centre (also known as SC Signal). Babkin previously worked with the chemical, radiological and biological defence structures within the Russian Ministry of Defence, including the 27th Scientific Centre and the Military Academy for Radiological, Chemical and Biological Defence. Babkin led a group of researchers at the Signal Scientific Centre that researched and published articles on the synthesis of epibatidine, which was found in Alexei Navalny after his death. He is therefore involved in the development of epibatidine as a chemical weapon. Therefore, Igor Babkin is involved in the	3.7.2026



			development of chemical weapons. Furthermore, he is associated with Artur Aleksandrovich Zhirov, who is the Director of SC Signal.	
27.	Sergey Yevgenyevich GALAN (Сергей Евгеньевич ГАЛАН)	Gender: male DOB: 13.6.1970 POB: Kramatorsk, USSR (now Ukraine) Nationality: Russian Function: senior scientist at the Signal Scientific Centre (also known as SC Signal, INN 7718813855)	Sergey Galan is a senior scientist within the military sphere working at the Signal Scientific Centre (also known as SC Signal). Galan previously worked with the chemical, radiological and biological defence structures within the Russian Ministry of Defence, including the 27th Scientific Centre, the State Scientific-Research Institute for Experimental Medicine and the Research Institute for Applied Acoustics. Together with colleagues at the Signal Scientific Centre, he has researched and published articles on the synthesis of epibatidine, which was found in Alexei Navalny after his death. He is therefore involved in the development of epibatidine as a chemical weapon. Therefore, Sergey Galan is involved in the development of chemical weapons. Furthermore, he is associated with Artur	3.7.2026



			Aleksandrovich Zhironov, who is the Director of SC Signal.	
28.	Irina Dmitriyevna DEREVYAGINA (Ирина Дмитриевна ДЕРЕВЯГИНА)	Gender: female DOB: 24.3.1961 Nationality: Russian INN: 772815862404 Function: chemical research analyst at the State Scientific Research Institute for Organic Chemistry and Technology (GosNIIOKhT)	Irina Derevyagina is a chemical research analyst at Russia's State Scientific Research Institute for Organic Chemistry and Technology (GosNIIOKhT). She authored two research papers on the clinical applications and testing of epibatidine, which was found in Alexei Navalny after his death. She is therefore involved in the development of epibatidine as a chemical weapon. Therefore, Irina Derevyagina is involved in the development of chemical weapons.	3.7.2026
29.	Mikhail Vasilyevich GUTSALYUK (Михаил Васильевич ГУЦАЛЮК)	Gender: male DOB: 2.3.1968 Nationality: Russian INN: 460501189420 Function: colonel and head of the department for organising scientific work and preparing scientific and pedagogical staff for the Military Academy for Radiological, Chemical and Biological Defence	Mikhail Gutsalyuk is a colonel and head of the department for organising scientific work and preparing scientific and pedagogical staff at the Military Academy for Radiological, Chemical and Biological Defence. Together with chemists from the Signal Scientific Centre (also known as SC Signal), he has conducted research on the synthesis of epibatidine, which was found in Alexei Navalny after his death. He is therefore involved in the	3.7.2026



			development of epibatidine as a chemical weapon. Therefore, Mikhail Gutsalyuk is involved in the development of chemical weapons. Furthermore, he is associated with Artur Aleksandrovich Zhiron, who is the Director of SC Signal.	
30.	Olga Petrovna YUDINA (Ольга Петровна ЮДИНА)	Gender: female DOB: 24.11.1986 Nationality: Russian INN: 462601484461 Function: senior researcher at the Signal Scientific Centre (also known as SC Signal, INN 7718813855)	Olga Yudina is a senior researcher at the Signal Scientific Centre (also known as SC Signal). She also receives a salary from the Research Institute for Applied Acoustics, which has been involved in procuring materials that could be used in the production of chemical weapon agents. Together with colleagues at the Signal Scientific Centre, she has researched and published articles on the synthesis of epibatidine, which was found in Alexei Navalny after his death. She is therefore involved in the development of epibatidine as a chemical weapon. Therefore, Olga Yudina is involved in the development of chemical weapons. Furthermore, she is associated with Artur Aleksandrovich Zhiron,	3.7.2026



			who is the Director of SC Signal	
31.	Aleksey Vadimovich AKSYONOV (Алексей Вадимович АКСЕНОВ)	Gender: male DOB: 8.10.1978 Nationality: Russian INN: 366217317327 Function: researcher at the Signal Scientific Centre (also known as SC Signal, INN 7718813855)	Aleksey Aksyonov is a researcher at the Signal Scientific Centre (also known as SC Signal). Together with colleagues at the Signal Scientific Centre, he has researched and published articles on the synthesis of epibatidine, which was found in Alexei Navalny after his death. He is therefore involved in the development of epibatidine as a chemical weapon. Therefore, Aleksey Aksyonov is involved in the development of chemical weapons. Furthermore, he is associated with Artur Aleksandrovich Zhirov, who is the Director of SC Signal.	3.7.2026’.

ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2026/1542/oj>

ISSN 1977-0677 (electronic edition)



VENDIM

Nr. 639, datë 27.8.2026

**PËR TRANSFERIMIN E PRONËSISË SË
89,652% TË AKSIONEVE TË
SHOQËRISË “DUHAN CIGARE” SHA,
NË LIKUIDIM, SHKODËR, NGA
MINISTRIA E EKONOMISË DHE
INOACIONIT TEK
BASHKIA SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar; të paragrafit të tretë, të nenit 4, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e pronësisë së 89,652% të aksioneve të shoqërisë “Duhani Cigare” sh.a., në likuidim, Shkodër, nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit tek Bashkia Shkodër, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu**

VENDIM

Nr. 640, datë 27.8.2026

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 667, DATË 29.7.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME
TË AKREDITIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 8, të nenit 4, të ligjit nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 667, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, para akronimit “DPA” shtohen fjalët “... në vijim ...”.

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe selia e saj ndodhet në Tiranë.”.

3. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit operon në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet kombëtare, evropiane dhe ndërkombëtare, rregulloret, udhëzuesit dhe kërkesat për akreditim.”.

4. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. DPA-ja ka detyrim plotësimin në mënyrë të vazhdueshme të kërkesave të neneve 9, 10 dhe 11, të ligjit nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon e drejton të gjithë veprimtarinë e saj, si dhe përfaqëson institucionin në marrëdhënie me të tretë. Drejtori i përgjithshëm asistohet dhe mbështetet nga zëvendësdrejtori i përgjithshëm për përmbushjen e objektivave të institucionit, duke bashkërenduar dhe mbikëqyrur veprimtari dhe funksione të



veçanta të strukturave të DPA-së, përcaktuar me urdhër dhe delegim të drejtorit të përgjithshëm, si dhe në rregulloren e brendshme. Zëvendësdrejtori i përgjithshëm kryen, gjithashtu, detyrat e menaxherit të cilësisë, sipas kërkesave të standardit ISO/IEC 17011:2017 “Vlerësimi i konformitetit – Kërkesat për organizmat e akreditimit që akreditojnë organet e vlerësimit të konformitetit”.”.

5. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. DPA-ja dërgon në ministri, deri në datën 31 janar të çdo viti kalendarik:

- a) raportin vjetor të DPA-së dhe objektivat për vitin pasardhës;
- b) raportin vjetor të Bordit të Akreditimit;
- c) raportin në lidhje me ankesat dhe apeli;
- ç) raportin në lidhje me shkallën e kënaqësisë së klientëve.

Raporti vjetor publikohet në faqen zyrtare të DPA-së brenda 10 ditëve nga miratimi.”.

6. Pika 15 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“15. Organet e vlerësimit të konformitetit, të regjistruara në Shqipëri dhe të akredituara nga organizma akreditues të huaj, informojnë DPA-në brenda 30 ditëve kalendarike për marrjen e akreditimit të tyre dhe deri më 31 janar të çdo viti për statusin e tyre të akreditimit.”.

7. Në pikën 18, fjalët “... në pikën 15 ...” zëvendësohen me “... në pikën 17 ...”.

8. Pika 20 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“20. DPA-ja ka logon dhe simbolin e saj të regjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale. DPA-ja i jep të drejtën organeve të akredituara prej saj të përdorin simbolin e akreditimit. Simboli i akreditimit përbëhet nga logoja e DPA-së, standardi kundrejt të cilit janë akredituar, vlerësimi i konformitetit dhe numri i akreditimit. DPA-ja publikon rregullat e përdorimit të simbolit të akreditimit në faqen zyrtare të saj.”.

II. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

VENDIM

Nr. 642, datë 27.8.2026

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I LINJËS 110 kV FIER–KAFARAJ DHE VENDOSJA E TRAKTIT TË RI NË NËNSTACIONIN FIER”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i linjës 110 kV Fier–Kafaraj dhe vendosja e traktit të ri në nënstacionin Fier”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë” dhe “pyll”, me një vlerë të përgjithshme prej 173 647.31 (njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e dyzet e shtatë pikë tridhjetë e një) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 173 647.31 (njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e dyzet e shtatë pikë tridhjetë e një) lekësh, përballohet nga buxheti i Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.



7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.

8. Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

10. Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., pas miratimit të këtij vendimi, aplikon menjëherë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, e cila brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të vendimit, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a., për pasuritë që shpronësohen, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a., për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Albana Koçi



LISTA EMËRORE E PRONARËVE PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE PREKEN NGA SHPRONËSIMI PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “NDËRTIMI I LINJËS 110 kV FIER–KAFARAJ DHE VENDOSJA E TRAKTTIT TË RI NË NËNSTACIONIN FIER”

